REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr._____/2026

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10352, DATË 18.11.2010, "PËR ARTIN DHE KULTURËN", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën" i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat për hartimin dhe zbatimin e politikave publike në fushën e artit dhe kulturës në Republikën e Shqipërisë, kuadrin e organizimit, administrimit, funksionimit dhe financimit të institucioneve publike të artit dhe kulturës në nivel qendror dhe vendor, instrumentet e mbështetjes së krijimtarisë artistike, artistëve, organizatave, si dhe rregullon kushtet dhe mekanizmat për krijimin, prodhimin, promovimin, shpërndarjen dhe prezantimin e veprave artistike, pasurimin e koleksioneve të artit dhe garantimin e aksesit dhe

4. "Fond publik i artit dhe kulturës" është fondi buxhetor që krijohet nga shteti për mbështetjen dhe fuqizimin e artit e të kulturës në vend, i cili ka rol të drejtpërdrejtë në rritjen e klimës artistike dhe të produktit artistik e kulturor.

5. "Kulturë" është tërësia e tipareve dalluese shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale që karakterizojnë një shoqëri, duke përfshirë vlerat, traditat, gjuhën, artin, letërsinë, dijen, besimet dhe mënyrat e jetesës, të cilat shprehin identitetin kombëtar dhe shoqëror dhe ndikojnë në zhvillimin e shoqërisë.

6. "Prodhim artistik" është procesi i konceptimit, planifikimit, organizimit, përgatitjes dhe realizimit të një vepre, aktiviteti ose projekti artistik, që përfshin burimet njerëzore, krijuese, teknike, materiale dhe financiare të nevojshme për realizimin e tij.

7. "Profesionist i kulturës" është individi ose personi fizik që ushtron në mënyrë profesionale veprimtari të lidhura me krijimin, prodhimin, menaxhimin, organizimin, promovimin, transmetimin, ruajtjen, dokumentimin, edukimin ose zhvillimin e artit dhe kulturës, përfshirë rolet teknike, administrative, kuratoriale, menaxheriale dhe çdo fushë tjetër që mbështet veprimtarinë artistike e kulturore.

8. "Projekt artistik" është një veprimtari ose tërësi veprimtarish me karakter krijues, artistik ose kulturor, të konceptuara dhe të organizuara për realizimin e një ose disa objektivave të përcaktuara, brenda një periudhe kohore dhe nëpërmjet përdorimit të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare.

9. "Skena e pavarur kulturore" është tërësia e artistëve, profesionistëve të kulturës, organizatave jofitimprurëse dhe subjekteve të tjera private, që ushtrojnë veprimtari krijuese, prodhuese, interpretuese, organizative, menaxheriale ose promovuese në fushën e artit dhe kulturës, jashtë strukturave organizative të institucioneve publike të artit dhe kulturës.

10. "Subjekt privat që ushtron veprimtari në art dhe kulturë" është personi fizik ose juridik privat, i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, që ushtron veprimtari krijuese, artistike, kulturore, prodhuese, organizative, menaxheriale ose promovuese, në një ose disa nga fushat e artit dhe kulturës.

11. "Vepër arti" është krijimi origjinal i një ose disa artistëve, i shprehur në çdo formë ose mënyrë, përfshirë formën materiale, letrare, muzikore, pamore, skenike, fotografike, kinematografike, audiovizuale ose digjitale, që përbën rezultat të veprimtarisë krijuese artistike dhe shpreh individualitetin krijues të artistit ose artistëve.

Neni 4

Pas nenit 4, shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1
Fushat e veprimtarisë artistike dhe kulturore

1. Në kuptim të këtij ligji, fushat e veprimtarisë artistike dhe kulturore përfshijnë:
a) artet pamore, arte të aplikuara, fotografinë dhe dizajnin (grafik, industrial e digjital);
b) artet skenike, artet performuese dhe artet muzikore;
c) kinematografinë dhe krijimtarinë audiovizuale;
ç) letërsinë dhe veprimtarinë botuese;
d) artet digjitale, multimedian dhe format inovative të shprehjes artistike;

dh) veprimtaritë bibliotekare dhe arkivore me karakter kulturor, dokumentar, kërkimor, edukativ dhe promovues, përfshirë veprimtaritë për promovimin e librit, leximit dhe trashëgimisë së shkruar, si dhe administrimin, dokumentimin dhe vënien në dispozicion të publikut të materialeve bibliotekare dhe arkivore, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi;

e) veprimtaritë artistike dhe kulturore të institucioneve muzeore, që lidhen me koleksionet e artit, përfshirë koleksionimin, dokumentimin, studimin, kurimin, ekspozimin, interpretimin, promovimin dhe edukimin artistik e kulturor, në përputhje me misionin e institucionit dhe legjislacionin përkatës;

ë) veprimtaritë artistike dhe kulturore që lidhen me identifikimin, dokumentimin, interpretimin, transmetimin, promovimin dhe gjallërimin e trashëgimisë kulturore jomateriale, folklorit dhe traditave të gjalla, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë;

f) veprimtaritë kërkimore, kuratoriale, edukative, formuese dhe profesionale në fushën e artit dhe kulturës;

g) format e tjera artistike, kulturore dhe multidisiplinare, që kontribuojnë në zhvillimin dhe diversitetin e krijimtarisë dhe shprehjes artistike e kulturore.

2. Veprimtaritë e parashikuara në pikën 1 të këtij neni ushtrohen në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi që rregullon fushat përkatëse, pa cenuar kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përcaktuara në këtë legjislacion".

Neni 5

1. Në pikën 3, të nenit 5, pas shkronjës "e", shtohen shkronjat "ë", "f", "g" dhe "gj", me këtë përmbajtje:

"ë. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit;

f. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë;

g. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit;

gj. institucione të tjera publike qendrore të artit dhe kulturës, të krijuara me ligj ose me akt nënligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe që ushtrojnë funksione në fushën e artit dhe kulturës;

2. Pas pikës 4, shtohet pika 5, më këtë përmbajtje:

"5. Për institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës, organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohen me ligje të posaçme, dispozitat e këtij ligji zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e ligjeve të posaçme përkatëse që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e tyre".

Neni 6

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshon me këtë përmbajtje:

"2. Institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës kanë për qëllim përmbushjen e funksioneve publike në fushën e artit dhe kulturës, në përputhje me interesin publik, misionin dhe fushën e përgjegjësisë së secilit institucion, si dhe me politikat kombëtare të zhvillimit kulturor. Në varësi të natyrës dhe fushës së veprimtarisë së tyre, ato ushtrojnë, ndër të tjera, këto funksione:

a) krijimin, zhvillimin, prodhimin, interpretimin, koleksionimin dhe menaxhimin e veprave të artit, arkivimin, promovimin dhe shpërndarjen e veprave dhe produkteve artistike e kulturore;
b) mbrojtjen, zhvillimin dhe përcjelljen e identitetit dhe trashëgimisë kulturore kombëtare, duke garantuar njëkohësisht hapësirë për pluralizmin e shprehjes artistike, krijimtarinë bashkëkohore dhe diversitetin kulturor;
c) zhvillimin e praktikave të reja artistike, kërkimit, eksperimentimit dhe inovacionit në fushën e artit dhe kulturës, përfshirë përdorimin e formave dhe teknologjive të reja të shprehjes dhe komunikimit;
ç) ofrimin e veprimtarisë artistike dhe kulturore për publikun, duke garantuar akses të gjerë dhe të barabartë dhe duke nxitur pjesëmarrjen kulturore të të gjitha grupeve dhe komuniteteve;
d) mbështetjen, prezantimin dhe promovimin e krijimtarisë shqiptare, si dhe bashkëpunimin dhe shkëmbimin me krijimtarinë dhe institucionet kulturore ndërkombëtare;
dh) zhvillimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar përmes projekteve, bashkëprodhimeve, shkëmbimeve profesionale, turneve, festivaleve, rezidencave, programeve të edukimit dhe formave të tjera të bashkëpunimit kulturor;
e) dokumentimin, koleksionimin, restaurimin, arkivimin, regjistrimin dhe shpërndarjen e veprimtarisë artistike e kulturore, përfshirë përdorimin e mjeteve audiovizive dhe teknologjive digjitale;
ë) edukimin kulturor, zhvillimin e audiencave dhe ndërmjetësimin kulturor, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe të aksesit në art e kulturë;
f) krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të artistëve dhe profesionistëve të kulturës, përfshirë programet e formimit, zhvillimit të kompetencave, mobilitetit dhe shkëmbimit profesional;
g) digjitalizimin, ruajtjen afatgjatë, administrimin, ndërveprueshmërinë dhe sigurimin e aksesit në koleksionet e trashëgimisë kulturore e dokumentare në format fizik dhe digjital, sipas legjislacionit përkatës.
2. Pas pikës 2, shtohen pika 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:
"3. Institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me parimet e autonomisë profesionale dhe artistike, lirisë së shprehjes dhe krijimtarisë, pluralizmit artistik, aksesit publik, transparencës, profesionalizmit, diversitetit kulturor dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit.
4. Mënyra e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve, kategoritë e shërbimeve dhe produkteve artistike e kulturore, si dhe format e bashkëpunimit dhe të financimit përcaktohen në aktin e krijimit, statutin, rregulloren e institucionit, në përputhje me misionin, fushën e veprimtarisë dhe legjislacionin në fuqi.
5. Statuti dhe rregullorja e institucionit nuk mund të krijojnë kompetenca, funksione ose detyrime financiare që nuk parashikohen në ligj ose në aktin e krijimit të institucionit dhe nuk mund të bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi".

Neni 7

Në nenin 7 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
"1. Në pikën 1, pas togfjalëshit "bordi artistik" shtohen fjalët "ose organi tjetër kolegjial me funksione këshillimore apo profesionale, sipas statutit të institucionit dhe legjislacionit në fuqi".
2. Pika 3 ndryshon si më poshtë:

"3. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të institucioneve publike të artit dhe kulturës miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, me propozimin e titullarit të institucionit përkatës, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon një procedurë tjetër për miratimin e saj".

Neni 8

Në nenin 8, pas togfjalëshit "bordi artistik" shtohen fjalët "ose organi tjetër kolegjial përkatës, sipas funksioneve dhe përgjegjësive të përcaktuara për të në aktet e institucionit, në përputhje me rregullat për përbërjen, kriteret e përzgjedhjes, papajtueshmëritë dhe parandalimin e konfliktit të interesit, të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi".

Neni 9

Në nenin 10, pika 3 ndryshon si më poshtë:

"3. Bordi artistik përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë: një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat, një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe pesë personalitete të shquara të fushës së artit ose të veprimtarive shoqërore që lidhen me të. Anëtarët emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën. Pesë anëtarët që përfaqësojnë personalitetet e fushës emërohen nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën, mbi bazën e propozimeve të titullarit të institucionit publik qendror të artit dhe kulturës. Për çdo pozicion anëtari, titullari i institucionit paraqet të paktën 3 (tre) kandidatura. Anëtarët e bordit nuk mund të jenë të punësuar në institucionin pranë të cilit funksionon bordi. Mandati i tyre është 4-vjeçar, me të drejtë riemërimi. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit, anëtari zëvendësohet, sipas së njëjtës procedurë dhe për të njëjtën kategori përfaqësimi, për pjesën e mbetur të mandatit."

Neni 10

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12
Burimet e financimit dhe tarifat

"1. Burimet e financimit të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës janë:
a) financimet nga Buxheti i Shtetit, ku përfshihen:
i. financimet për shpenzimet operative dhe administrative, investimet dhe pajisjet teknike;
ii. financimet e akorduara nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën për realizimin e repertorit vjetor dhe veprimtarive artistike e kulturore;
b) të ardhurat nga administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve që kanë në administrim, përfshirë arkivat, fondet dokumentare dhe materiale të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
c) të ardhurat nga shitja e biletave për shfaqjet dhe veprimtaritë artistike e kulturore;
ç) të ardhurat nga shitja dhe shfrytëzimi ekonomik i veprave artistike e kulturore të prodhuara, për të cilat institucioni zotëron ose ushtron të drejta pasurore, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të;

d) të ardhurat nga shërbimet bibliotekare, bibliografike, dokumentare, digjitale, riprodhimi i dokumenteve, botimet, veprimtaritë formuese dhe shërbime të tjera profesionale, në përputhje me misionin e institucionit dhe legjislacionin për të drejtën e autorit;
dh) të ardhurat nga financimet e përfituara përmes aplikimeve në programe, projekte dhe burime të tjera të ligjshme financimi, në përputhje me objektin e veprimtarisë dhe statutin e institucionit;
e) donacionet dhe sponsorizimet;
ë) të ardhura të tjera të ligjshme.
2. Të ardhurat e realizuara sipas shkronjave "b" "c", "ç" dhe "d" të pikës 1, të këtij neni, administrohen nëpërmjet sistemit të thesarit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor. Nga këto të ardhura, 90 për qind përdoren për financimin e veprimtarisë së institucionit që i realizon, nëpërmjet buxhetit të miratuar të tij, ndërsa 10 për qind derdhen në Buxhetin e Shtetit.
3. Pjesa e të ardhurave që mbetet në dispozicion të institucionit publik qendror të artit dhe kulturës, sipas pikës 2 të këtij neni, përdoret për financimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së tij, për:
a) realizimin e prodhimeve artistike e kulturore, repertorit vjetor dhe projekteve të reja artistike;
b) mbulimin e shpenzimeve të lidhura drejtpërdrejt me organizimin dhe realizimin e shfaqjeve dhe veprimtarive artistike e kulturore;
c) dhënien e shpërblimeve për cilësinë artistike, sipas kritereve dhe masave të miratuara nga bordi artistik, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, si dhe sipas kufijve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për pagat dhe shpërblimet në institucionet publike, brenda fondeve buxhetore të disponueshme;
ç) promovimin e veprimtarisë artistike e kulturore, zhvillimin e audiencave dhe rritjen e aksesit të publikut në art dhe kulturë;
d) zhvillimin profesional, kualifikimin dhe trajnimin e personelit artistik, teknik dhe administrativ;
dh) mbulimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime të nevojshme për funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarisë artistike e kulturore të institucionit;
e) komisionimin, blerjen dhe koleksionimin e veprave të artit;
ë) veprimtari të tjera që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Të ardhurat e tjera të realizuara nga veprimtaria e institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës administrohen dhe përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet përkatëse, kur është rasti.
5. Planifikimi, administrimi dhe përdorimi i të ardhurave, sipas këtij neni, kryhen nga institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Titullari i institucionit është përgjegjës për administrimin dhe përdorimin e ligjshëm, ekonomik, eficient dhe efektiv të këtyre të ardhurave.
6. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën monitoron realizimin, administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, nëpërmjet raportimit periodik financiar dhe të veprimtarisë. Institucionet paraqesin pranë ministrisë

raportet përkatëse, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
7. Tarifat për shërbimet e ofruara nga institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës përcaktohen në bazë të kostos së shërbimit, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, transparencës, trajtimit të barabartë dhe garantimit të aksesit të publikut në art dhe kulturë. Për kategori të caktuara përfituesish mund të parashikohen tarifa të reduktuara ose përjashtime nga pagesa, përfshirë fëmijët, nxënësit dhe studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit e tyre, studiuesit, grupet pjesëmarrëse në veprimtari edukative, si dhe kategori të tjera të përcaktuara me legjislacion të posaçëm.
8. Masa e tarifave për shërbimet, kategoritë përfituese të reduktimit ose përjashtimit nga pagesa, si dhe rregullat dhe procedurat për zbatimin, administrimin dhe mbledhjen e tyre, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën dhe ministrit përgjegjës për financat, në përputhje me parimet dhe kriteret e përcaktuara në pikën 7 të këtij neni".

Neni 11

Në shkronjën "c" të nenit 29, hiqet togfjalëshi "Qendrën Kombëtare të Artit e Kulturës".

Neni 12

Në nenin 35, pas pikës 1 shtohen pikat 2 dhe 3, me këtë përmbajtje:
"2. Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton udhëzimin në zbatim të pikës 6 të nenit 12 të këtij ligji.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën dhe ministrit përgjegjës për financat, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton vendimin në zbatim të pikës 8 të nenit 12 të këtij ligji".

Neni 13
Dispozitë kalimtare

Institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, marrin masat për harmonizimin e statuteve dhe rregulloreve të tyre me dispozitat e ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.